



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E  
ORGANIZUAR  
KANCELARI**

Nr. 957 Prot.

Tiranë, më 13 .11.2023

**Lënda:** *Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak për procedurën e ngritjes në detyrë në kategorinë e mesme drejtuese Drejtor, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.*

**KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*Godina "Poli i Drejtësisë", Rruga "Ana Komnena",*

**TIRANË**

Në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", nenit 17, të Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor", në përfundim të verifikimit paraprak të kandidatëve, për përmbushjen e kushteve të procedurës së ngritjes në detyrë dhe kërkesave të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurim, ju njoftojmë se për:

- **1 (një) vend vakant në pozicionin Drejtor, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, kategoria e mesme drejtuese, në Gjykatën e Posaçme të Apelit Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar,**

është paraqitur 1 (një) kandidaturë, e cila plotëson kushtet e përgjithshme:

**1. Alma Hysi**

Në lidhje me kriteret e veçanta (kushtet e sigurisë që duhet të plotësojnë kandidatët përpara se të caktohen apo punësohen në këtë pozicion, sipas nenit 6 të ligjit nr. 95/2016), për të vazhduar më tej në fazën e vlerësimit profesional sipas nenit 19 të Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020 të KLGJ, pritet Raporti nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës.

*Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin!*

